

JANI THOMAJ

MBI RENDIN E FJALËVE NË STRUKTURËN E FRAZELOGJIZMAVE TË SHQIPES

Siç dihet, ndërmjet tipareve dalluese të frazeologjizmave të gjuhës, uniteti semantik i komponentëve dhe funksioni gramatikor i frazeologjizmit në tërësi përbëjnë dy më të rëndësishmit ¹.

Megjithatë shpesh herë, kur frazeologjizmat hyjnë në fjali të ndryshme, jo vetëm nuk e ruajnë skemën, rendin e fjalëve të modelit të tyre fillestar, por edhe çpërbëhen, meqenëse këputet lidhja, uniteti semantik dhe gramatikor i frazeologjizmit: gjymtyrët e tij mund të kryejnë funksione të ndryshme brenda në fjali ose në fjali të ndryshme. Në rastin e fundit fenomeni është më i qartë, sepse frazeologjizmi pëson edhe ndryshime të tjera të dukëshme, kurse brenda një fjalie problemi merr një karakter relativ. Thelbi i çështjes zbulohet në këtë formë: në gjuhën shqipe gjatë prishjes së rendit të fjalëve të modelit fillestar të frazeologjizmit, gjatë ndërftjes së fjalëve të tjera nëmes komponentëve të tij dhe gjatë shpërndarjes së gjymtyrëve të tij në fjali të ndryshme a ndryshon funksioni sintaktik i frazeologjizmit, a prishet uniteti semantik në kuptimin *frazeologjik*, shkurt a çpërbëhet ai? Nëqoftëse po, atëhere në ç'drejtim dhe deri në ç'skallë?

Zgjidhja e këtij problemi do t'i jepte përgjigje edhe një pyetjeje tjetër të rëndësishme, që karakterizon vetë frazeologjizmat gjuhësorë të shqipes, si dhe të disa gjuhëve të tjera: cili nga këto dy tipare (uniteti semantik apo funksioni gramatikor) është më esenciali për frazeologjizmat e gjuhës? Ndryshe këtë mund ta formulonim edhe kështu: nëqoftëse frazeologjizmi nuk përbën më një gjymtyrë të vetme të fjalisë, a prishet uniteti semantik i tij, a çpërbëhet ai?

Këto çështje po i shtrojmë përmbledhtas në këtë kumtesë. Lidhur me këto nuk mund të mos prekim kalimthi edhe disa çështje të tjera, si p.sh. shkaqet që sjellin ndryshimin e kuptimit të frazeologjizmit, shkaqet që prishin rendin e fjalëve të modelit fillestar të frazeologjizmit etj.

*
* *
*

Zakonisht në shqipe shumë frazeologjizma, sidomos ata me karakter të theksuar idiomatik, ka mundësi të hyjnë në fjali si një gjymtyrë e

1) Më gjerë në «Probleme të frazeologjizmave të gjuhës shqipe», «Studime Filologjike», 1964, II-III.

vetme, si kryefjalë, kallëzues, plotës etj. 2. Por, sikurse ekziston mundësia e prishjes së rendit të fjalëve të modelit fillestar, ashtu ekziston mundësia edhe e shpërndarjes së gjymtyrëve të frazeologjizmit. Shpërndarja e komponentëve ndodh jo vetëm brenda një fjalie, por edhe në fjali të ndryshme. Në rastin e parë shpërndarja e komponentëve bëhet për shkak të futjes nëmes tyre të fjalëve të tjera plotësuese, që lidhen herë me njerin herë me tjetrin komponent. Kategoria leksiko-gramatikore e fjalës që ndërfitet nëmes komponentëve të frazeologjizmit, përcaktohet nga komponenti prej të cilit varet formalisht; në një frazeologjizëm foljor *folje + emër* mund të ndërfitet si ndajfolja e lidhur me foljen, ashtu dhe mbiemri i lidhur me emrin etj., fjala vjen «kam shumë uri» dhe «uri të madhe ka»; p.sh. «.besoj se paskëtaj *do verë mjaft mënt.*» (Postoli, Lulja. . 41) 3; «Ani pra Shqypetarët e sodit /*s'çajn fort kryet* për punë t'Kastriotit.» (Fishta, Gomari., 7) 4; «Por, kujtoj, *s'ka kund nevojë / Qi un t'i xa kta ndopak n'gojë.*» (Po aty, 6); «Unë s'e kam vvarë *ka q mendjen* për këto.» (Shuteriqi, Çlirimtarët II, 120) 5; «Tani që u zhyt në milici *do ta qelbi ndonjë hendek* kundi.» (Po aty, 18); «E ktheu *shpejt fletën* e tha: .» (Kuteli, Një natë., 85) 6; «Sonte ta prisha *një çikë gjaknë.*» (Po aty, 82); «Mirë, asaj mos i bjerë *shumë më qafë*, se ka pesë çiliminj, .» (Po aty, 57); «Zotrote më *hyre menjëherë në zemër* se qënke i mirë, gojëmjaltë, mustaqemadh.» (Po aty, 75); «Ymer Deliu nuk e *thyen fare zemrën.*» (Kuteli, Tregime. ., 166) 7; «Po Shqipëria *ngriti përsëri krye* me armë në dorë.» (Po aty, 210); «. . s'munda të mposht Arbërinë e vogël. E *shtina një herë në dorë*, copa-copa, po ma shkuli Skenderbeu. .» (Po aty, 232); «E vari, po nuk ja *theu dot zemrën.*» (Po aty, 260); «. . ndryshe unë s'e *vë dot dorën në zjarr* për asnjeri. .» (Xoxa, Lumi. . II, 61) 8; «I *hante pra pë kurrizi* për kalorës e dhëmbët për mëgojëz..» (Po aty, 87); «Njeriu, rëndom, lodhur nga mëdyshjet, të cilave *s'u jep dot udhë*, . . kënaqet dhe me një gënjeshtër, . .» (Po aty, III 27); «Po në kanë ata turp të thonë që Shqipëria është mëma jonë, Shqipëria *ka më shumë turp* e dhunë të duketë që ka të tillë bij!» (S. Frashëri: «Shqipëria ç'ka qënë. .», 91); «Për mua, një koqe grurë / më *hyn më mirë në punë*» (Çajupi, Mëmëdheu, 59-60) 9; «Që ta marrë me të mirë, / *Zoti dha këtë këshillë:*» (Po aty, 73) etj. Ndërfuten edhe fjalë të tjera që lidhen me frazeologjizmin në tërësi, ose që s'lidhen fare me 'të drejtpërdrejt, por nëpërmjet marrëdhënieve sintaktike në fjali, p.sh.: «Dera s'u hap me të parë. / si *kish e gërcira shpresë*, se keci s'i zuri besë.» (Çajupi, Mëmëdheu, 133); «Mos bëj *kurr njeri / me të mëdhenj shoqëri*» (Po aty, 35); «Mbasandej kah pak kah pak / *ka me u vu punëve kapak*» (Fishta, Gomari. . 48); «Merret vesht, njana dhe tjetra / *kryet shoshoges kanë m'ia lmue*» (Po aty, 49); «Se ata, besa m'ndigjo mue / *Nuk i kanë shkrimet zanat.*» (Po aty, 69); «Në *ka njeri frikë* se mos e mbyt kjo bukë,

2) Shih psh. «Kramatika e gjuhës shqipe (Pjesa e dytë. Sintaksa. Botim III, Tiranë 1957)» të Prof. M. Domit, për shprehjet *mbaj mend, kam frikë, ngul këmbë, i zë besë, e qis në krye* (një punë), *i bëj ballë, ve vesh, ve në dorë, ishte në mbarim e sipër, më vjen keq, ra shi* etj. (f. 28), *Bashkimi Sovjetik, Deti i Zi, Biblioteka Kombëtare* (f. 23).

3) *Foqion Postoli, Lulja e Kujtimit, Tiranë 1959, f. 41.*

4) *A. G.J. Fishta, Gomari i Babatasit, Shkodër 1941, f. 7.*

5) *Dh. S. Shuteriqi, Çlirimtarët, vëll. II, Tiranë 1955, f. 120.*

6) *Mitrush Kuteli, Një natë tetori, në rev. «Nëndori», 1965/7, f. 85.*

7) *Mitrush Kuteli, Tregime të moçme shqiptare, Tiranë 1965, f. 166.*

8) *Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, vëll. II, Tiranë 1965, f.61.*

9) *Andon Zako Çajupi, Mëmëdheu, Tiranë 1958, f. 59-60.*

ja ku po ha unë i pari» (Shuteriqi, Çlirimtarët, I 45); «Ma merr mendja se, po ta kishe pasë ti në dorë do t'i zbulojsh femnat.» (Stërmilli, Sikur., 89) 10; «Po të mos kishte marrë ma shkulli pjesë aktive në veprën e kryeme nuk kishte se si të bahej turpi. (Po aty, 137); «Hop! shkon plaka e piqet me Xixovicën, e ve punën në vijë.» (Kuteli, Një natë., 84); «. . zhvatte andej e jipte këtej, gjersa e shtinte njerin në kllapë.» (Po ai, Tregime., 212); «Më thua, moj trimëria ime, për sa të bën ty zemra?» (Po aty, 227); «Kur mori ngjarja dhenë, turku brohoriti, arbëri u kredh në zi» (Po aty, 257); «Për peshk po flet, o Miço, po shiko mos të shtrojnë sot në dru e të bëjnë edhe ty peshk, . . » (Xoxa, Lumi., II 55) etj.

Gjithë këto tregojnë se bashkësia strukturore formale e frazeologjizmave të shqipes nuk është një gjë absolute dhe në këtë karakteristikë togfjalëshat frazeologjikë të kësaj natyre përputhen me togfjalëshat e lirë. Do thënë gjithashtu se nuk duhet absolutizuar edhe mundësia e ndërftjes së fjalëve në frazeologjizmat. Tipi i frazeologjizmave me karakter idiomatik të theksuar (si *vë re*, *bëj pallë*, *i jap dum*, *më ra bretku* etj.) është më kompakt jo vetëm nga shkrirja e linjave të brendëshme semantike, por edhe nga struktura formale, që nuk lejon ose, së paku, «nuk pëlqen», ndërftjen e fjalëve të tjera. Shkaqet e ndërftjes së fjalëve në konstruktet frazeologjike janë të ndryshme dhe në këtë pikë s'po hyjmë në hollësira.

Po kështu të ndryshme janë edhe shkaqet e ndryshimit të rendit të fjalëve të modelit fillestar të frazeologjizmit. Tek rastet «Ç'faj ka bërë, ç'gjynahe pagan?» (Çajupi, Mëmëdheu, 14); «Që ditënë që të pashë, / zëmërnë time ta dhashë.» (Çajupi, Vepra, 69) 11; «. . po të tërë vdiqnë dhe në varr i vunë!» (Po aty, 66); «Shini Adhamutn' e mjerë, / se ç'heq fatziu me grua / Sos qirinë do t'i mbajë, / sos të shara të durojë,» (Po aty, 79); «. . , kur të vdes do të më qani, / për mua zi do të mbani!» (Po aty, 74); «Prapa diellit të venë, (tradhëtarët) / se çnderuan mëmëdhenë.» (Po aty, 104); «nga hunda s'më heq dot kurrë, / se nuk jam si çdo burrë!» (Po aty, 102); «Haxhi Aliu paska vdekur! Fatziu deputet, sa rëndë më vjen!» (Po aty, 264); «N'parlament kleri s'do t'shkojë / . . sepse klerit besë s'i xihet» (Fishta, Gomari., 68); «Gja Shqypnija n'dorë nuk ka.» (Po aty, 25); «. . kujë për ta nder mend s'i bjen.» (Po aty, 7); Po Fijes as tërr s'i bëri veshi.» (Kuteli, Një natë., 86) etj. duket që mospërputhja e rendit të fjalëve me skemën e modelit fillestar ka ardhur si rezultat i përforsimit emfatik, i kërkesave të stilit a gjinisë letrare etj. Po për këtë shkak ndryshon struktura e frazeologjizmit edhe tek urimet, sharjet, mallëkimet etj. Duke qenë se në to vlera ekspresive emocionale është e përhershme, ajo ka sjellë që pikërisht skema sekundare e rendit të fjalëve jo në përputhje me skemën e modelit fillestar, të jetë më e zakonshme në përdorim për shkak të një fosilizimi më të madh të atyre lidhjeve sintaktike; ndërtimi i tyre me dëshiroren e foljes shpreh ngarkesën emocionale që mbajnë dhe kjo nga ana e saj ka çuar në ngurosjen e këtyre lidhjeve sintaktike sekundare. Pikërisht tek mallëkimet, urimet, sharjet kryesisht dhe pastaj më pak tek proverbat, fjalët e urta e shprehje të tjera emocionale del qartë roli që luan ngarkesa emocionale në prishjen e rendit fillestar të fjalëve, p.sh.: «M'i ka mësuar gjyshja, ndjesë pastë!» (Çajupi, Vepra, 277); «Na! porrato paç / kur kërkon të shaç!» (Po aty,

10) Haki Stërmilli, Sikur t'isha djalë, Tiranë 1959, f. 89.

11) Andon Zako Çajupi, Vepra, Tiranë 1957, f. 69.

115); «*Nalet paç* moj dashuri / se më trete si qiri!» (Po aty, 78); «*I pasur, të palltë varri!* / Ti që bleve dashurinë / dhe nuk e le si më pari, / *të martë djalli shpyrtinë!*» (Po aty, 77); «*Vaj më rëntë pika!* Moj korba, s'më thoi, / kush e pagëzoi?» (Po aty, 122); «*Zoti ta dhuroftë!* / *Këmbë mbarë qoftë!*» (Po aty, 119); «*Se nga ajo ha e pi...* / *Ndaj e mori me një sy,* / *i dalçinë që të dy*» (Po aty, 103); «*Tek unë mir' se të vish*» (Po aty, 125); «*Zoti nun, mir'se më erdhe,* / po verën pse na e derdhe?» (Po aty, 125); «*Më qafë më paçi o bjeshkë të larta!*» (Kuteli, Tregime..., 97); «*... shpirt mos pastë kush nxori pasqyrën.*» (Po ai, Një natë..., 58); «*Më qafë paçin* vehten e tyre se fshati u doli borxhit.» (Xoxa, Lumi., II 52) etj. Megjithatë shpesh herë konstruktet të tilla gjinden në të folur e në të shkruar edhe në skemën fillestare që përputhet me rregullat e rendimit logjik të gjymtyrëve të gjykimit; kështu tek po ai autor kemi edhe: «*Po paçi uratë,* / se me këtë msim / mike, që më dhatë / sot mendja m'u kthye. (Çajupi, Vepra, 146-147); «*Qoftë këmbë mbarë.* / *Dy dit' që ke pjellë* / dhe ngriëj bën gjellë» (Po aty, 118) etj. Po edhe në këta shembuj lidhja sintaktike është e ngurosur. I njëjti fenomen duket, siç thamë, edhe tek proverbat, gjëzat, fjalët e urta etj., p.sh. «*Tym pa zjarr nukë ka kurrë.*» (Po aty, 111) etj. Interesant është të vërehet se «ngrirja» e frazeologjizmit në lidhje sintaktike të brendëshme që nuk përputhen me ato të modelit fillestar, nga një herë është kaq e madhe sa që sot pikërisht ajo duket e zakonshme, p.sh. «nga hekur bënet dhe thika, / kur e zëmë na zë frika.» (Çajupi, Vepra, 237); «*ea se më mori gjumi.* . . *fli të martë lumi*» (Po aty, 108); «*Jorgjin e la Perëndia (= nuk vdiq) / shpresë për mëmën e tia;*» (Po aty, 54); «*i mori dreqi të tërë!* (Çajupi, Mëmëdheu, 162) etj. Një gjë e tillë vihet re bile edhe jashtë kushtëzimit ekspresivo-emocional e stilistikor, sidomos me dy grupe frazeologjizmesh shqip.

Së pari, vihet re me grupin e frazeologjizmave me strukturë folje + emër në rasën emrore, që me një analizë të brendëshme sintaksore të mundëshme do t'i pëgjigjej formulës kallëzues + kryefjalë, — siç shihet e anasjellura e modelit fillestar kryefjalë + kallëzues. Konstrukte të tilla i gjejmë si në prozë, si në poezi, pra s'janë pjellë e kërkesave të gjinisë letrare. Ato gjinden pothuaj në çdo stil të gjuhës së shkruar e të folur, gjë që është një tregues me rëndësi që lejon të mendohet se konstruktet të tilla duhen spjeguar me vetë veçoritë e formimit të frazeologjizmave, me specifikën e evolucionit të tyre, me vlerën e tyre të përhershme ekspresivo-emocionale, me dëndësinë e përdorimit dhe karakterin e zakonshëm etj. P.sh. «*Nuk më ha malli të kuptoj se ç'flasin.*» (Stërmilli, Sikur., 170); «*Edhe mue, natyrisht, s'më shkoj mendja kund.*» (Po aty, 143); «*Nuk di, po diç më thotë zemra.*» (Kuteli, Tregime..., 149); «*... më thoni, kujt nga ju i bën zemra të ma sjellë këtu Skënderbenë.*» (Po aty, 236); «*e zu frika.*» (Postoli, Lulja., 50); «*... sa u kërkoi goja.*», «*... të ardhë zemra.*», «*ç'më ndezi groshi.*», «*... s'na e ha dhëmbi.*», «*... na bje bretku.*» (Kuteli, Një natë..., 56, 79, 75, 71, 69); «*... mëmës iu këput zemra.*», «*... Ymer Agës i ftohet zemra.*», «*... më ka plasur zemra të ta dëgjoj zërin.*», «*... e ze malli për nënën.*» (Kuteli, Tregime., 24, 55, 35, 29); «*... i doli boja qeverisë.*» (Shuteriqi, Çlirimtarët, I, 116, 172); «*... nuk të bën zemra ta shohësh.*» (Po aty, II 20); «*Iu ngroh zemra.*» (Xoxa, Lumi., II 110); «*... s'ia kishte zënë syri.*» (Po aty, 68); «*Vita e pikasi menjëherë se ku i hante zemra nënës.*» (Po aty, 158); «*Ty duhet të të digjet zemra,* o burrë, për këtë gjëmë që na ra sot.» (Po aty, 189); «*... sa i hëngri krahu.*» (Po aty, 11); «*... mos sot, nesër, do t'i vijë goja.*» (Po aty, 57) etj. Me një rend të tillë fjalësh këto konstruktet përdoren edhe në të

folur të përditshëm. Kështu në shqipen e folur (si në të shkruarën) sot thuhet zakonisht: ma *merr mendja*, *s'më bën zemra*, i *doli boja*, i *erdhi goja* etj. dhe jo: *mendja ma merr*, *zemra s'më bën*, *boja i doli* etj., përveç rastesh të veçanta, në përputhje me intonacionin dhe llojin e fjalisë.

Së dyti, vihet re me grupin e frazeologjizmave që kanë më shumë se dy komponentë, por përsëri me një emër në emrore, i cili vjen edhe në këtë rast pas foljes, p.sh. «. . i ka marrë koka erë.» (Kuteli, Një natë. . . , 91); «Plakës i bëhet zemra mal.» (Po aty, 75); «Sot më zuri ferra këmbët.» (Po aty, 57); «I kishte ardhur shpirti në majë të hundës.» (Po aty, 60); «. . s'ja ha qeni stapnë.» (Po aty, 103); «ku ha pula gur.» (Shuteriqi, Çlirimtarët, II 16); «. . pa ndonjë shpresë që t'i zinte këmba dhe» (Xoxa, Lumi. . . , II 132); «. . i hipi gjaku në tru.» (Po aty, 219; por edhe: «. . gjaku i hipi në kokë.» , 214) etj. Me këtë mënyrë konstrukti formal i këtij grupi përputhet me atë të frazeologjizmave që përbëhen nga një folje, një emër në kallëzore dhe një fjalë tjetër, si p.sh.: «. . hedh hi syve.» (Kuteli, Një natë. . . , 72); «Ja vunë këmbët në një këpucë.» (Po aty, 81); «Leksi zuri kokën me duar.» (Xoxa, Lumi. . . II 94); «Po të marrin vesh, do venë dorën në zemër.» (Po aty, 214) etj. Me këtë mund të nxirrnim një përfundim me rëndësi për shqipen, që në tipin foljor të frazeologjizmave dy ose më shumë gjymtyrësh zakonisht në krye qëndron gjymtyra foljore. Kjo mund të lidhet jo vetëm me raportet e brendëshme të frazeologjizmave, por edhe me raportet e jashtme të tyre me fjalë të tjera kur hyjnë në fjali. Veçse një përfundim i tillë do një vërtetim më të plotë.

Gjithë sa u tha gjer këtu, u tha për të vërtetuar se skema formale e frazeologjizmave të shqipes shpesh herë shmanget nga skema «klasike» e togfjalëshave të lirë dhe për një arësyje a një tjetër ajo mund të kristalizohet në një skemë që duket si e përmbysur, por që sot në të vërtetë s'ndjehet më si e tillë, sidoqë në një analizë të brendëshme sintaktike të mundëshme kryefjala vjen gjithnjë pas kallëzuesit dhe ky pas kundrinës. Përkundrazi, konstrukti fillestar i këtyre kryefjalë-kallëzues-kundrinë në vend të kundrinë-kallëzues-kryefjalë nuk është më neutral dhe gjindet gjithënjë në shprehje me vlerë ekspresive-emocionale ose në ndërtim të kushtëzuara nga kërkesat e stilit. P.sh. «Fjala mos na daltë e marrtë dhenë. . .» (Çajupi, Vepra, 258); «Duket mëndja të ka lënë.» (Po aty, 152); «Tani, dreqi do t'u marrë.» (Po aty, 141); «Në bëjnë kshu të mëdhejtë. / djalli t'i marrë për jetë!» (Po aty, 108); «Mos më shaj, Zoti të faltë», (Po aty, 96) etj. Lind pyetja: me këtë ndryshim të rendit të fjalëve a ndodh që ta humbasin ngarkesën emocionale këto shprehje? Jo, edhe pse skema e ndërtimit të tyre përputhet me skemën logjike të gjymtyrëve të gjykimit. Mund të mendohet që skema e tyre të jetë zhvilluar në këtë mënyrë: në fillim skema kryefjalë-kallëzues-kundrinë; ky konstrukt, për shkak të ngarkesës emocionale që kanë pasë marrë këto shprehje, e ka prishur rendin fillestar të fjalëve, duke u kthyer në skemën kundrinë-kallëzues-kryefjalë (ose kallëzues-kryefjalë-plotës etj.); pastaj me kohë ky konstrukt u bë kaq i zakonshëm në përdorim sa që për të shprehur emocionet u ndje nevoja të riprishej rendi i fjalëve, kështu që konstrukti sekundar kundrinë-kallëzues-kryefjalë etj. u rikthye në skemën primare kryefjalë-kallëzues-kundrinë, me ekspresivitet.

Mospërputhja e rendit të fjalëve në frazeologjizëm me rendin e fjalëve të modelit fillestar vihet re edhe në togfjalëshat frazeologjike që hyjnë në fjalitë (zakonisht të pavarura, të bashkërenditura me fjali kundërshtore) me kuptim konkluziv, në të cilat shprehet përgjigja e një

pyetjeje të bërë a të supozuar më parë, por që vërtetësia e përmbajtjes së kësaj përgjigjeje, e para, konsiderohet si e padiskutueshme dhe, e dyta, me të mund të vijë në kundërshtim diçka tjetër, p.sh. *durim kam* po lodhem shpejt; *frikë s'kam* as nga ti as nga ai; *udhë marr* edhe kur bie dëborë; «Dhëria në vështë / / hap degat e mbulon vendë, / dhe përpyjetë s'mund të vejë, / se ka një barrë të rëndë:» (Çajupi, Vepra, 236); siç shihet, ndryshimi i rendit të fjalëve në rrethana të tilla bëhet me qëllim që të nxirret në krye të fjalisë ajo fjalë, e cila përmban kuptimin themelor të bashkimit të fjalëve, e cila është vatër kuptimore e frazeologjizmit (kur është komponent i tij).

Një vend në vargun e fjalëve të disa frazeologjizmave ze edhe trajta e shkurtër përemrore në funksion të kundrinës së drejtë a të zhdrejtë, gjë që e ndryshon skemën në kundrinë-kallëzues-kundrinë, p.sh. të mos e *mbash fjalën* e dhënë nuk është burrëri etj. Po jo në çdo rast ajo është gjymtyrë e frazeologjizmit. Siç u tha, rendi i fjalëve si në fjali përgjithësisht ashtu edhe në frazeologjizëm veças, ndryshon edhe për shkak të gjinisë letrare, ku është përdorur shprehja e dhënë. Kështu në përputhje me kërkesat e vargjeve të poezisë edhe shprehjet më të ngurosura mund të çpërbëhen në komponentët e tyre dhe këta të ndërrojnë vend, bile dhe të shpërndahen në vargje të ndryshme, p.sh. «nga mëndj'e vet s'do të dalë.» (Çajupi, Vepra, 243); «s'më bën dot gjë Shqipëria. / Dhe sa të jem vet'i gjallë, / nga zgjedha s'ka për të dalë.» (Çajupi, Mëmëdheu, 24); «Mikia nër mënt e vu, / në shtëpi të saj më shpu,» (Çajupi, Vepra, 93); «të tëra këto të gjara / ndër mënd i shkon;» (Çajupi, Mëmëdheu, 56); «po mbarë s'vanë, / se shumë u vranë.» (Po aty, 115) etj. Po kështu ka raste edhe të shpërndarjes së komponentëve të frazeologjizmit në vargje të ndryshme: «Dy mushka një ditë muar / udhë bashkë ndë rrëpirë.» (Po aty, 48); «Kush rrëmon në këtë jetë / varrë shokut, bie vetë.» (Po aty, 123) etj.

Mjaft të lirë në renditjen e komponentëve janë frazeologjizmat që formohen nga dy fjalë semantikisht korelative (si sinonime, antonime etj.), p.sh. *dit' e natë* — *nat' e ditë*, *posht'e lart* — *lart' e poshtë*, *kok' e këmbë* — *këmb' e kokë*, *gjat' e gjerë* — *gjer' e gjatë*: «Kandilja me vaj / digjej *nat' e ditë*, / ndrinin qiritë» (Çajupi, Mëmëdheu, 119); «punon *dit' e natë*». (Po aty, 99); «Puna s'bënet me një natë, / do mentuar *gjer' e gjatë*». (Po ai, Vepra, 109) etj.

Ndryshimi i rendit të fjalëve të frazeologjizmit dhe ndërputja e fjalëve nëmes komponentëve të tij në gjuhën shqipe, kur nuk ndryshohet raporti i brendshëm i gjymtyrëve të frazeologjizmit, nuk çon në ndryshimin e kuptimit të tij. Për këtë mjafton të krahasohen këta dy shembujt të Çajupi: «Ndë kohë të vjetër / një lop' e një dhi / dhe një dele tjetër / bënë shoqëri / bashkë me luanë.» (Mëmëdheu, 51); «Mos bëj kurrë njeri / me të mëdhenj shoqëri.» (Po aty, 35). Nuk çpërbëhet frazeologjizmi e nuk ndryshon kuptimi i tij edhe me një rend sekundar të komponentëve brenda një fjalie kohore, kur lidhëza kohore kur hyn nëmes fjalëve përbërëse të frazeologjizmit, p.sh. «. . . , edhe shpyrti kur të më dalë, / moj mike do të të dua.» (Çajupi, Vepra, 73); «po ndë duar kur t'u bjerë, / mos e lini / se s'e zini / tjetër herë.» (Çajupi, Mëmëdheu, 143). Këtu «çrregullimi» i shkaktuar nga nevojat e vargut, nuk i prish lidhjet e brendëshme semantike ndërmjet gjymtyrëve të frazeologjizmit.

Kur komponentët e frazeologjizmit shpërndahen dhe kanë funksione të veçanta sintaktike në fjali të ndryshme, — e themi që në krye, — frazeologjizmi pushon së qeni njësi unike. Për frazeologjizmat foljorë të

tipit *folje + emër* shpërndarja e komponentëve bëhet në këtë mënyrë: emri shërben si kryefjalë a kundrinë (kjo varet nga funksioni i brendshëm që ka pasur në frazeologjizëm, d.m.th. nga dietaza e foljes) e një fjali kryesore a të varur të një shkalle më të lartë, prej së cilës varet një fjali me kallëzues komponentin tjetër të frazeologjizmit, — foljen. Fjalia e dytë është një fjali lidhore caktuese, e paraprirë nga një përemër lidhor, — i cili zëvendëson emrin ish komponent të frazeologjizmit dhe lidh këtë fjali pikërisht me atë fjalë të fjalisë së mëparshme, e cila ka qenë komponent i frazeologjizmit. P.sh. «Burrat nënë hie, / lozën kuvendojnë; — / pika që s'u bie, / se nga gratë rrojnë!» (Çajupi, Mëmëdheu, 30); «se me këtë *msim*, / mike, që më dhatë / sot, mëndja m'u kthye.» (Çajupi, Vepra, 146-147); «Po mos harro, të lutem, *fjalën* që më dhe për shkrimin.» (Po aty, 261); «Që të tre burrat ishin bukuroshët Nikua, Nuçi dhe Tushi, të cilët pas *vendimit* që *bënë* natën e shkuar ardhë në shtëpi të Dhimitrit» (Postoli, Lulja. . , 42); «Halil Garri — t'i thuash — më ka dërguar jot motër të të pyes: ku e ke *besën* që i ke *dhënë*?» (Kuteli, Tregime. . , 34) etj. Është e qartë që këtu gjymtyrët e frazeologjizmit fillestar janë shkëputur njera nga tjetra, hyjnë në raporte të tjera në fjali me variantin leksiko-semantik të fituar që më parë.

Ndër tipat e frazeologjizmave gjymtyrët e bashkimeve frazeologjike kanë aftësinë më të madhe të shpërndahen në fjali. Kjo vjen nga që komponentët e bashkimeve frazeologjike gëzojnë më tepër pavarësi, relativisht me tipat e tjerë. Rrjedhimisht, në këtë tip ekziston mundësia e inversionit, e ndërftjes së fjalëve të tjera nëmes komponentëve, e lidhjes së mbiemrave, emrave, ndajfoljeve etj. me njërin ose tjetrin komponent formalisht (prepozicionalisht ose postpozicionalisht). Siç kuptohet, këtu ndërftja e fjalëve të tjera, shpërndarja e gjymtyrëve të bashkimit frazeologjik dhe lidhja e plotësit dhe e cilësorit me të nuk prishin karakterin frazeologjik të bashkimit, ndodh dhe funksionin sintaktik të tij si kallëzues i fjalisë. Po mund që disa tipa të shihen edhe si togfjalësha të zbërthyeshëm sintaktikisht.

Një çështje për t'u gjurmuar këtu është edhe roli që luan fjalia plotësuese (a cilësuese), e cila, siç u tha, i ngjitet formalisht komponentit folje (a emër). Kjo fjalë, që s'është gjymtyrë e frazeologjizmit mund të shërbejë si plotës për foljen-kallëzues, si cilësor i emrit-kryefjalë a kundrinë ose si plotës i gjithë togut frazeologjik-kallëzues. Ky faktor, sadoqë është jashtëm dhe formal, padyshim ka vlerën e vetë në përcaktimin e natyrës sintaktike të frazeologjizmit. Mirëpo a do të thotë që përshtatja, fjala vjen, e një mbiemri me emrin-komponent të frazeologjizmit e kthen frazeologjizmin në një bashkim të lirë fjalësh? Nga vëzhgimet e gjertanishme në këtë pikë mbi materialin e shqipes dhe nga shqyrtimi i disa studimeve mbi frazeologjinë e gjuhëve të ndryshme romane e sllave formohet mendimi se në përgjithësi mbiemrat, të lidhur me emrin, nuk e prishin unitetin semantik dhe në thelb nuk ia ndryshojnë kuptimin frazeologjizmit, por vetëm e plotësojnë atë kualitativisht dhe jo aq emrin, se sa tërë frazeologjizmin¹². Kur themi *kam shumë shpresë . . . ose kam shpresë të madhe se . . .*, kuptimi dhe funksioni i grupit *kam shpresë* mbetet po ai: *shpresoj*.

12) Përkundrazi, E.I. Turçinskaja mendon që «në shumicën e rasteve të përdorimit, nuk mund të fusësh një cilësor, pa ndryshuar kuptimin e shprehjes dhe pa prishur strukturën frazeologjike të saj, sepse mundësia e cilësimit të emrit tregon që ai vepron në kontekst si emërtim i një nocioni sendor të pavarur»: Э. И. Турчинская, „Глагольные устойчивые сочетания в современном французском языке“, Москва 1953 г. 13.

Mbiemrat në bashkime të tilla afrohen për nga kuptimi i tyre me ndajfoljet, sepse ata shprehin jo aq cilësinë e komponentit emror të frazeologjizmave, por më tepër, me ndërmjetësinë e tij, rrethanën, karakteristikën cilësore (kualitative) të të gjithë lokucionit. Si dëshmi e funksionit ndajfoljor në këto raste të mbiemrit shërben edhe fakti që shumë frazeologjizma të zgjeruar me mbiemra kanë si sinonime togfjalësha të përbërë nga një folje dhe një ndajfolje, p.sh. *kam besim të plotë* dhe *besoj plotësisht* 13.

Është një gjë e ditur që në bashkimet frazeologjike të tipit *folje + emër* lind një kuptim i ri, i vetëm, nga shkrirja e kuptimit të drejtpërdrejtë të emrit me kuptimin frazeologjikisht të lidhur të foljes. Pra, folja hyn në frazeologjizëm me një kuptim jo konkret-fizik, po të figurshëm. Kur emrit i shtohet një mbiemër nuk priset as frazeologjizmi as kuptimi i tij, sepse, siç dihet, karakterin frazeologjik ndër bashkimet frazeologjike e përcakton pikërisht gjymtyra foljore. Nga ana tjetër edhe kuptimi i emrit nuk ndryshon nga bashkëlidhja me mbiemrin. Po kjo mund të thuhet në përgjithësi edhe për ndajfoljen që i ngjitet foljes formalisht.

Gjithashtu duhet shënuar se me zgjerimin e modelit fillestar të frazeologjizmit me ndajfolje, mbiemra etj. nuk ndryshon as lloji i lidhjeve sintaktike ndërmjet komponentëve. Këto përbëjnë forcat e brendëshme, të cilat nuk lejojnë të zërthehet frazeologjizmi gjatë ndryshimeve të tilla të modelit fillestar. Në rastin kur komponentët e bashkimit frazeologjik shpërndahen në fjali të ndryshme dhe kryejnë funksione sintaktike të ndryshme në ato fjali, çështja ndryshon. Karakterizimi i këtij rasti në gjuhësi është i ndryshëm, sipas pikëmbështetjes prej nga niset gjuhëtari. Për unitetin dhe ekzistencën e frazeologjizmit shumë dijetarë vlerësojnë funksionin gramatikor, kryesisht sintaktik të tij në fjali, lidhjen e frazeologjizmit si tërësi me fjalë të tjera, bile dhe rendin e fjalëve. Faktorët e tjerë mendohen si të dorës së dytë. Anasjelltas, të tjerë linguistë venë si bazë të ekzistencës së frazeologjizmit unitetin semantik të komponentëve. Sado të jenë të rëndësishëm faktorët sintaktikë, morfologjikë dhe fonetikë për frazeologjizmat e shqyrtuar, ata megjithatë mbeten të dorës së dytë në krahasim me faktorët semantikorë. Qëndrueshmëria e bashkimeve frazeologjike foljore duhet kuptuar para së gjithash si qëndrueshmëri semantike, si një lidhje e përhershme reciproke kuptimore e komponentëve të modelit fillestar, dmth. të foljes dhe emrit. Lidhjet semantike të komponentëve janë lidhje vendimtare për jetën e bashkimeve frazeologjike. Duke zhdukur ato, zhduket dhe frazeologjizmi. Bile mundësia e shumicës së frazeologjizmave për të luajtur rolin e një gjymtyre të vetme të fjalisë është rrjedhim i unitetit semantikor të komponentëve. Në gjuhën shqipe gjatë ndryshimit të rendit fillestar të fjalëve përbërëse të frazeologjizmave, gjatë zgjerimit të tyre me fjalë të tjera, gjatë ndërfitjes së fjalëve e shprehjeve të tjera nëmes komponentëve dhe gjatë shpërndarjes së komponentëve brenda fjalisë nuk priset uniteti dhe bashkëveprimi reciprok kuptimor nëmes fjalëve përbërëse, dmth. frazeologjizmat nuk çpërbëhen, sadoqë në sintaksën formale nganjëherë, ata shihen si të analizueshëm sintaktikisht në dy pjesë të ndryshme të fjalisë (p.sh. mund të mendohet që *kam shpresë* të merret jo si kallëzues foljor i përbërë, po

13) Një fenomen i tillë vërtetohet për spanjishten nga V.S. Vinogradov: *Krh. në span. «Soltar una impúdica carcajada» dhe «reirse impudicamente» (= «nxjerr një të qeshur të paturpshëm», dhe «qesh paturpësisht»)*. В. С. Виноградов, „О некоторых видоизменениях исходной модели фразеологического сочетания в предложении“, në „Романская филология“ № 204, из-ство АУ 1957 ф. 137.

si kallëzues foljor i thjeshtë *kam* dhe kundrina e tij *shpresë*, duke u mbështetur për një analizë të tillë në mundësinë që kanë komponentët veçmas për *t'u lidhur* me fjalë të tjera: *kam shumë shpresë, kam urdhër të prerë, ka një uri ujku* etj.). Sido që të jetë, bashkimi frazeologjik vazhdon të jetojë, sepse: e para, secili komponent vazhdon të ruajë kuptimin që kishte në modelin fillestar, folja atë figurativ, të lidhur frazeologjikisht dhe emri kuptimin e drejtpërdrejtë konkret — sendor ose abstrakt (tek bashkimet frazeologjike *folje+emër*); e dyta, bashkëveprimi i komponentëve mbetet i pandryshuar, kuptimi frazeologjikisht i lidhur i foljes mbetet, si rezultat i lidhjes që ka ajo po me fjalën e modelit fillestar, — folja vazhdon t'i japë *karakterin* frazeologjik bashkimit, kurse emri vazhdon të përcaktojë *kuptimin* frazeologjik, — raporti sintaktik midis tyre mbetet po ai i modelit fillestar; e treta, edhe në rrethanat e reja bashkimi frazeologjik ka një kuptim të vetëm frazeologjik, ekuivalent me një fjalë të vetme. Pas kësaj rregulla e do që bashkimet frazeologjike edhe në këto rrethana të merren si një pjesë e vetme e fjalisë. Mirëpo në këtë pikë faktorët e jashtëm, siç u tha, kanë vlerën e tyre dhe zgjidhja e problemit duhet parë konkretisht. Si përfundim mund të themi se rendi i fjalëve, inversioni, ndërputja, zgjerimi me fjalë të tjera dhe shpërndarja e komponentëve të frazeologjizmit brenda për brenda fjalisë në gjuhën shqipe nuk kanë rol kuptimndryshonjës dhe nuk e prishin frazeologjizmin. Ato vetëm «e ngarkojnë» frazeologjizmin me nuanca emocionale, e plotësojnë atë me rrethana të reja; kjo vërtetohet edhe nga një faktor tjetër: edhe në rrethanat e reja frazeologjizmi ruan disa veçori formale të modelit fillestar, fjala vjen, komponentët nuk mund të ndryshojnë formën gramatikore, nuk mund të zëvendësohen me sinonimet e tyre etj., nëqoftëse këto veçori i kanë pasur në modelin fillestar. As elementët fonetikë nuk ndikojnë në frazeologjizmat e shqipes. Shkaqet që mund të ndryshojnë kuptimin e frazeologjizmit ose ta prishin atë fare, janë të tjera. Nga këto po përmendim: 1) Ndryshimin e kuptimit të njerit apo tjetrit komponent të frazeologjizmit, p.sh., bashkimet e fjalëve *e hodhi lumin, e vuri përpara* etj. mund të jenë edhe bashkime të lira edhe të qëndrueshme. Kjo varet se në ç'kuptim kanë hyrë në këto lidhje fjalët *lumi (e hodhi lumin)* dhe *vuri përpara (e vuri përpara)*. Në rastin e parë, nëqoftëse fjala *lumi* hyn në lidhje me kuptimin e saj të drejtpërdrejtë, konkret-sendor, atëhere bashkimi *e hodhi lumin* nuk është frazeologjizëm, vetëm folja përdoret në një nga kuptimet e saj derivate, togu nuk njëzohet as semantikisht as formalisht, ai tregon një veprim real të drejtpërdrejtë: *kaloi lumin*. Në rastin e dytë, të dyja fjalët përbërëse janë shkrirë në një njësi të vetme semantike me kuptimet e tyre të figurshme (p.sh. *e kam vënë përpara* punën); por bashkimi i këtyre fjalëve mund të jetë i lirë, kur fjalët hyjnë në lidhje me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, p.sh. *ve (një send) përpara (vehtes)*. 2) Zëvendësimin e një fjale të frazeologjizmit me një tjetër. Ky ndryshim çon ose në prishjen e frazeologjizmit (p.sh. *ha ana = anon* dhe *ha fruta* etj.), ose në ndryshimin e kuptimit të tij (p.sh. *bëj durim* edhe *bëj pallë* etj.), ose në ndërrimin e tipit të frazeologjizmit (p.sh. *marr vesh* edhe *marr zotim, i ranë pendët* dhe *i ra vlera* etj.). 3) Ndryshimin e formës gramatikore të njerës apo tjetrës fjalë. Në gjuhën shqipe ka mjaft frazeologjizma, në të cilët duket mvartësia e kuptimit frazeologjik të bashkimit nga veçoritë gramatikore të tij, dmth. ndryshimet e theksuara semantike shkaktohen shpesh nga veçoritë gramatikore të fjalëve që hyjnë në përbërjen e frazeologjizmit. Por jo të gjitha kuptimet gramatikore të komponentëve të frazeologjizmit

janë të kufizuara, p.sh. folja vërtet është komponenti semantikisht më i lidhur, sepse hyn në frazeologjizëm me një kuptim frazeologjikisht të lidhur, por nga ana gramatikore (morfologjike) ajo s'ka asnjë kufizim në frazeologjinë shqipe, dmth. mund të zgjedhohet plotësisht edhe brenda frazeologjizmit pa e prishur as frazeologjizmin, as kuptimin frazeologjik. Ndërkaq emri shpesh është i lirë leksikisht, por i kufizuar nga ana e kategorisë gramatikore të trajtës, numrit, rasës, p.sh. *bëj durim* (trajta), *i hedh një sy* (gazetës) dhe *hedh sytë*, *i hap synë* (djalit) dhe *hap sytë* (numri), *marr më sysh* (rasa) etj. Mos respektimi i kategorisë gramatikore të emrit, në këto raste, do të çonte në prishjen e frazeologjizmave ose në ndyshimin e kuptimit të tyre. 4) Ndryshimin e funksionit sintaktik të komponentëve në fjali të ndryshme ose ndryshe, shpërndarjen e gjymtyrëve të frazeologjizmit në fjali të ndryshme. Dihet se në fjalinë e varur lidhore-caktuese të shqipes përemri *që* (*i cili*, *e cila*, *të cilët*, *të cilat*) kryen dy funksione: atë të lidhjes dhe atë të zëvendësimit të kryefjalës a kundrinës së drejtë. Është e vërtetë se kur përemri lidhor ndërfitet në një frazeologjizëm, atëherë foljes-kallëzues të frazeologjizmit të tipit *folje+emër* i mbetet kundrina frazeologjike, ajo vetëm është ndryshuar: është ngarkuar edhe me funksionin e fjalës lidhëse dhe është tani një përemër e jo emër. Përmbajtja kuptimore e kësaj «kundrinë-lidhëse» në fjali përcaktohet nga ajo fjalë, së cilës i përket dhe të cilën zëvendëson. Jo vetëm lidh komponentët e çkëputur të frazeologjizmit, por edhe zëvendëson në fjalinë e varur lidhore komponentin emror të togfjalëshit, i cili ka kaluar në pjesën tjetër të përparshme të fjalisë së përbërë. Është e vërtetë gjithashtu se me anë të këtij elementi gjuhësor realizohet lidhja semantike e pjesëve të frazeologjizmit, mirëpo ky e ndryshon fort modelin fillestar. A mund të mendohet se në këtë rast frazeologjizmi nuk çpërbëhet? Përkundrazi, na duket se faktet e shqipes na çojnë në përfundimin që në gjuhën shqipe, kur gjymtyrët e frazeologjizmit shpërndahen në fjali të ndryshme, frazeologjizmi nuk ekziston më, çpërbëhet, p.sh. «E humba dhe atë pak *durim* që *pata*» ose «*durimin* e madh që *ka ai*, s'e gjen tek asnjë tjetër»; «*Mua Rina më gënjeu*, / prishi *benë* që *kish* bërë» (Çajupi, Vepra, 36) etj. Siç shihet në këto raste, frazeologjizmi *kam durim* pëson disa ndryshime shumë esenciale: a) S'ka më unitet frazeologjik nga ana kuptimore ndërmjet *kam* dhe *durim*, ato nuk shkrihen më kuptimisht për të dhënë një kuptim të vetëm frazeologjik. b) Ndryshon lidhja sintaktike ndërmjet *kam* dhe *durim*, folja merr tjetër kundrinë (*që*) dhe emri bëhet kundrinë e një foljeje tjetër (*humba*, *gjen*). Në zberthimin e fjalive në togfjalësha, *kam* dhe *durim* nuk formojnë një togfjalësh më vehte po dy togfjalësha me fjalë të tjera: *humba durimin*, *gjen durimin* dhe *që ka*; rrjedhimisht, emri mund të ndryshojë edhe kategorinë gramatikore të rasës, si pasojë e lidhjes me foljen e fjalisë ku bën pjesë, p.sh. *durimi* që *ka* njeriu, nuk duhet shpërdoruar; *durimin* që *ka ai*, s'e gjen tek asnjë tjetër etj. c) Togu *që+kam* nuk formon frazeologjizëm meqë përemri *që* nuk është fjalë emërtuese, quajtëse. d) Emri pëson ndryshime edhe në formën gramatikore, sipas kuptimit gramatikor të ri që merr, p.sh. vihet në të shquarën ose edhe në të pashquarën, por i paraprirë tani nga nyja jo shquese ose fjalë të tjera që kërkojnë këtë trajtë. e) Gjymtyrët e frazeologjizmit bëhen gjymtyrë të fjalive të ndryshme, kryejnë funksione sintaktike në fjali të ndryshme. f) Ndërfutja (interkalimi) e fjalëve të tjera nëmes gjymtyrëve të frazeologjizmit tanimë është më e natyrshme se më parë.

Ndryshe mendon për këtë V.S. Vinogradov, i cili duke shqyrtuar

materiale të frazeologjisë spanjolle, mbrin në përfundimin se edhe në rastet kur komponentët e frazeologjizmit shpërndahen në fjali të ndryshme frazeologjizmi nuk priset (p.sh. *Disimula mucho, a lo que yo presumo, el cuidado que tiene de su persona* = Ajo zbulon, siç më duket mua, kujdesin që ka për personin e vet), meqenëse komponentët ruajnë po ato kuptime dhe po ato lidhje sintaktike, rezultati kuptimor i shkrirjes së tyre është po ai, uniteti i tyre duket dhe në faktin që «folja jo aq lehtë» e lëshon «nga vehtja emrin» dhe se «ajo ruan» «zëvendësin» e tij — lidhëzën përemrore (përemrin lidhor) «que»¹⁴.

Është e vërtetë se fjalët që përbënin frazeologjizmin, edhe të shpërndara në fjali të ndryshme, ruajnë po ato kuptime që kishin në modelin fillestar, p.sh. abstrakt, figurativ, derivat etj. Por, siç thamë, uniteti semantik (në kuptimin frazeologjik) ndërmjet tyre nuk ekziston më.

*
* *
*

Pra, uniteti semantik ndërmjet fjalëve të një togfjalëshi është esencial, por jo i vetmi në përcaktimin e këtij togfjalëshi si frazeologjizëm. Faktorë mjaft të rëndësishëm janë edhe ata sintaktikë, morfologjikë e leksikorë. Frazeologjizmat, si rrjedhim, në rrethana të caktuara leksikogramatikore mund të pushojnë së qeni frazeologjizma. Në gjuhën shqipe shpërndarja e gjymtyrëve në fjali të ndryshme e prish lidhjen ekzistuese frazeologjike dhe frazeologjizmin. Bile duhen parë jo absolutisht të pazbërthyeshme edhe rastet kur gjymtyrët e frazeologjizmit të tipit kalimtar (si *kam shpresë, kam uri, kam urdhër* etj.) shpërndahen brenda një fjalie, duke u plotësuar me fjalë të tjera (p.sh. *kam një uri ujku, kam shumë shpresë, kam urdhër të prerë* etj. Të tilla bashkime fjalësh mund të shihen edhe si të zbërthyeshme sintaktikisht, por nga pikëpamja leksikologjike na duket se frazeologjizmi e ruan karakterin e tij).

Nëqoftëse togfjalëshi është një gjymtyrë e vetme e fjalisë, po të ketë kushtet e tjera (p.sh. të përbëhet nga dy a më shumë fjalë emërtorë etj.), atëherë ai patjetër është frazeologjizëm. Nëqoftëse në analizën formale ai zbërthehet në dy gjymtyrë të fjalisë, atëherë ky është një faktor që na tregon se po shkon drejt çpërbërjes së tij, por jo determinues. Që mundësia të bëhet realitet duhet që të priset uniteti semantik (në kuptimin frazeologjik) i komponentëve, gjë që mund të arrihet kur gjymtyrët e frazeologjizmit kryejnë funksione të ndryshme në fjali të ndryshme. Pra, tipari esencial i frazeologjizmave gjuhësorë është uniteti semantik, por jo i pakushtëzuar, përkundrazi, i kushtëzuar nga funksioni gramatikor i togfjalëshit.

¹⁴) V.S. Vinogradov, art. i cit., f. 140-141.

Faint, illegible text, possibly bleed-through from the reverse side of the page.

Additional faint, illegible text, possibly bleed-through from the reverse side of the page.